
AKT THEMELIMI

"ALB-KOS GROUP" SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.

Emri i shoqërisë do të jetë "ALB-KOS GROUP" SHPK, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. Ortakët e shoqërisë janë:

1. Aurel Pepa, shtetas Shqiptar, atesia Skender i datëlindjes 26.03.1983 lindur në Lushnje dhe banues në Durrës, mbajtes i leternjotimit me numër identifikimi ID 036714283 dhe numër personal I30326121R.
2. Milazim Dragusha, shtetas Kosovar, atesia Qazim i datëlindjes 01.03.1965 lindur në Prishtinë dhe banues në Prishtinë, mbajtes i pasaportes me numër identifikimi P0112618.

3. Objekti i veprimtarisë.

Objekti i veprimtarisë do të jetë:


- Eksport-Import dhe tregëtim i lëndës drusore biomase pellet për djegie. Tregëti me pakice të kondicionereve, chillera, kaldaja, aspiratore, panele diellore, pajisje elektroshtepiake. Montim dhe mirëmbajtje për kaldaja, kondicionere, sisteme ftohje me ujë e gaz dhe gjeratore. Tregëti me pakice, import-eksport të mallrave industriale si lëndë djegëse për ngrohje (Pelet). Menaxhimin, blerjen, marrjen me qira, ndertimin, dhenien me qira ose në menaxhim, të aktiviteteve tregtare të shitjes me pakice dhe të veprave dhe strukturave që kanë lidhje me këto aktivitete. Shitje me pakice të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore. b. Ndertimin, menaxhimin dhe shitjen e dyqaneve për shitje të mallrave me pakice, për llogari të vetë apo të tretëve: blerjen, me për rifurnizimin, e mallrave ushqimore të përgjithshme,



ne bashkepunim me shoqeri dhe entitete te tjera, si dhe import-eksportin e mallrave te ndryshme qe do te jene objekt i aktivitetit tregtar; hapjen dhe drejtimin e "Agjencive Doganore" ne te gjithe territorin e Shqiperise per kryerjen e cdo praktike doganore, pasi te jete pajisur paraprakisht me lejet e nevojshme te leshuara nga organet kompetente; prodhimin, vete, ne forme te asociuar ose ne ortakeri me shoqata ose shoqeri te tjera, te produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore me destinacion rishitjen ne pikat e veta te shitjes ose te shoqerive ortake ose te kontrolluara prej saj si dhe/ose per eksportim; rritjen dhe shnderrimin e produkteve me origjine ushqimore, per qellime tregtimi brenda dhe jashte Shqiperise; dhenien me qira te pasurive te paluajtshme ne pergjithesi, blerjen; drejtimin, transformimin dhe shitjen e tokave bujqesore, sikurse dhe cdo veprim tjetër mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe studimin dhe ndertimin ose blerjen dhe shitjen e ndertesave qe kane lidhje me kete kategori; ofrimin 2 e sherbimeve administrative, konsulencave mbi pronen e paluajtshme, financiare, menaxhuese dhe teknike; marrjen hua si dhe dhenien e dorezanive dhe garancive te tjera reale dhe personale, edhe ne favor te te treteve. Drejtimin e veprimtarive tregtare me pakice ne bashkepunim edhe me shoqeri te tjera, me te cilat do te lidhe kontrata franchising dhe furnizimi. Per realizimin e objektit te veprimtarise se saj, Shoqeria mund te kryeje, gjithashtu, si aktivitet ndihmes dhe jo paresor, te gjitha veprimet mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, industriale, financiare dhe tregtare, ne Shqiperi si dhe jashte saj, ne masen qe vleresohet e dobishme dhe/ose e pershtatshme nga organi administrativ dhe mundet gjithashtu te marrfe persiper, gjithmone per qellime ndihmese, pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive ose ndermarrjeve dhe ose entiteteve te tjera me objekt te ngjashem, te afert ose te lidhur me te vetin, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, si dhe cdo aktivitet tjetër te lejuar nga ligjet ne fuqi. Te gjitha veprimtarite e pershkruara me siper mund te zhvillohen si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.



4. Selia e shoqërisë.

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Lagjia nr. 3 Rruga "Grigor Durrsaku", Sheshi "Liria" P.Biznesit, Zona Kadastrale 8514, Nr. pasurie 3\400-N49, Durres.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë.

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

6. Kapitali themeltar.

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000 (njëqind mijë) lekë**.
- Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota .
- Kontributi i ortakeve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:
- Aurel Pepa është zotërues i 1 (nje) kuote, me 67 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.
- Milazim Dragusha është zotërues i 1 (nje) kuote, me 33% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.



8. Administratori.


- Administratori Kryesor i shoqërisë emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar.
- Administratori i Dytë (me kompetenca të kufizuara) emërohet për një mandat 3 (tre) vjeçar.
- Administratorët emërohen ose shkarkohen nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administrator e shoqërisë është:
- Aurel Pepa, shtetas Shqiptar, atesia Skender i datëlindjes 26.03.1983 lindur në Lushnje dhe banues në Durrës, mbajtes i leternjotimit me numër identifikimi ID 036714283 dhe numër personal I30326121R.
- Kompetencat e administratorëve përcaktohen më në detaje në statutin e shoqërisë.

9. Likuidimi i shoqërisë.

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Aurel Pepa

Aurel Pepa 

Milazim Dragusha

Milazim Dragusha 

Datë 05.02.2024